



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21 Prill 2021

Nr: 274

**VENDIM**

**Objekt:** Për shqyrtimin e denoncimeve nr. 1846, 1848, 1851, 1854, 1858, datë 22.2.2021, për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

**Kërkues:** Partia Demokratike

**Ndaj:** Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

**Baza ligjore:** Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, 91, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar gjatë procesit të hetimit administrativ:

**VËREN:**

**I.Vlerësimi paraprak**

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, janë raportuar disa denoncime në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndalua”, në rubrikën “Kallëzo”, nga subjekti politik Partia Demokratike, me të njëjtin objekt “Miratimi i VKM-së nr. 100, datë 17.2.2021, në kundërshtim me dispozitat e vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”.

Sipas denoncimeve të raportuara më datë 22.2.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 1846, 1848, 1851, 1854, 1858, në ndërfaqen e KQZ-së pretendohet se: “Në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të datës 17.02.2021, është miratuar VKM-ja me objekt *“Për përcaktimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si autoritet kontraktor për zhvillimin e mundshëm të procedurës së koncesionit/partneritetit publik privat për Portin në Triport, Vlorë”*”.

Sipas denoncuesit: Miratimi i këtij akti është në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, nenin 3, pika 4, të Komisionit Rregullator, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ku parashikohet shprehimisht se:

*“Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, ndalohet dhënia e kontratave publike të koncesionit/partneritetit publik privat (PPP), për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen, nuk janë vijim i një procedure koncesionare të identifikuar dhe nisur, apo nuk janë parashikuar për t’u financuar nëpërmjet buxhetit të miratuar të vitit zgjedhor”*”.

Sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues Partia Demokratike, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

## II. Rrethanat e fakti



- Referuar denoncimeve të mësipërme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1635 prot., datë 2.3.2021, ka kërkuar informacion Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me iniciativën dhe ligjshmërinë e kësaj VKM-je, në përputhje me parashikimet e vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.
- Me shkresën nr. 2274/1 prot., datë 17.3.2021, protokolluar me tonën me numër 1635/1, datë 18.3.2021, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ka sqaruar se:

“Në datë 14.10.2020, përmes vendimit nr.1 Këshilli Kombëtar i Territorit ka miratuar Planin Kombëtar Sektorial të Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale (PKSTDIP). Përmes këtij plani, KKT ka ngarkuar institucionet qendrore që kanë administrim struktura portuale, Autoritetet Portuale / Portet që të marrin masat e nevojshme në zbatim të legjislacionit sektorial dhe atij të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, për hartimin e planeve të përdorimit dhe administrimit të tokës (masterplan) në përputhje me përcaktimet e PKSTDIP.

PKSTDIP në thelb një përditësim logjiko-juridik i Planit të Përgjithshëm Kombëtar “Shqipëria 2030”, miratuar përmes vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 881, datë 14.12.2016.

Në datën 16.9.2020, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë është protokolluar kërkesa me nr. 6579 prot., me objekt propozimin e pa kërkuar të projektit “Për dhënie me koncesion për ndërtimin, operimin dhe transferimin e një porti turistik në zonën e portit të Vlorës.”

Me shkresën nr. 394/6 prot., datë 21.10.2020 Këshilli i Mbikëqyrjes i “Portit Detar Vlorë” sh.a, ka përcjellë vendimin nr. 13, datë 20.10.2020, ku ka vendosur të japë pëlqimin dhe të mbështesë zbatimin e projektit për dhënie me Koncesion/PPP për ndërtimin, operimin dhe transferimin e një porti turistik në zonën e portit të Vlorës si dhe zhvendosjen e portit aktual në zonën e Portit të Peshkimit- Triport, sipas vendimit të KKT. Ky vendim i Këshillit Mbikëqyrës është miratuar nga Asambleja e Aksionarit e përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

*Sa më sipër parashtrohet në thelb miratimi i një projekti të madh me dy procedura vijuese ku e para është kusht i domosdoshëm për të dytën dhe anasjelltas.*

Me qëllim plotësimin e informacionit të nevojshëm për të mbështetur vendimmarrjen sa më sipër, si dhe në kuadër të veprimeve paraprake dhe përgatitore sipas përcaktimeve të ligjit nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, që të gjitha institucionet e përfshira kanë kryer për jetësimin e vendimit të KKT, në muajin tetor 2020 Porti Detar sh.a shpalli një procedure përmes së

cilës u kërkua përgatitja e një raporti teknik në parametrat e detyrës së projektimit me objekt “Shërbimi mbi vlerësimin e parametrave të rialokimit të aktiviteteve nga porti Vlorë tek Porti i Peshkimit”. Ky studim, i administruar në dosjen e procedurës “Për ndërtimin, operimin dhe transferimin e një porti turistik në qytetin e Vlorës”, parashikon një afat prej 36 muajsh, periudhën për realizimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja në triport pas përfundimit me sukses të procedurës së dhënies me koncesion të terrenit për ndërtimin e marinës turistike”. Në datën 1.12.2020 përmes Urdhrit nr. 338 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë është ngritur Komisioni i Dhënies së Koncesionit “Për ndërtimin, operimin dhe transferimin e një porti turistik në qytetin e Vlorës”, propozim i pa kërkuar.

Në datë 16.12.2020 përmes vendimit nr. 1023 të Këshillit të Ministrave ka vendosur në administrim të MIE të një pjesë të pronës shtetërore në zonën kadastrale nr. 8602, në pronësi të Portit Detar Vlorë sh.a, për tu përdorur, “të procedurës së dhënies me koncesion të terrenit për ndërtimin e marinës turistike”, në përputhje me planin Kombëtar Sektorial të Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale. Procedurë e përfunduar në datë 10.3.2021 ku është shpallur fituesi i kësaj procedure.

Nga sa më sipër del e qartë se VKM-ja nr. 100, datë 17.02.2021 “Për përcaktimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si autoritet kontraktor për zhvillimin e mundshëm të procedurës së koncesionit/partneritetit publik privat për Portin në Triport, Vlorë” është tërësisht në përputhje me zbatimin nr.9/2020 të Komisionit Rregullator.

Nga përshkrimi i detajuar dhe i datuar rezulton se, për rialokimin e aktivitetit të Portit Tregtar të Vlorës në zonë Triport, janë bërë njoftime publike dhe po ndiqet një procedurë koncensionare në vijim të tjetrës, ku procedura e parë është konkluduar me sukses”.

### III. Analiza ligjore

Neni 3, pika 4, e vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator parashikon “veprimtari të ndaluara”, edhe ato veprimtari që përfshijnë:

... “Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, ndalohet dhënia e kontratave publike të koncensionit/partneritet publik privat (PPP), për të cilat nuk është bërë njoftim publik se do të zhvillohen, nuk janë vijim i një procedure koncensionare të identifikuar dhe nisur, apo nuk janë parashikuar për t’u financuar nëpërmjet buxhetit të miratuar të vitit zgjedhor.”



Në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ nuk rezultoi e provuar se VKM-ja është në shkelje të kushteve të përcaktuar në nenin 3, pika 4, e vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Gjatë analizës së fakteve dhe provave të paraqitura, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se miratimi i VKM-së nr. 100, datë 17.02.2021 “Për përcaktimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si autoritet kontraktor për zhvillimin e mundshëm të procedurës së koncesionit/partneritetit publik privat për Portin në Triport, Vlorë”, është vijimësi e një procedure koncensionare të identifikuar dhe nisur përpara së të miratohej vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Miratimi i kësaj VKM-je ka ardhur si rezultat i të gjitha veprimeve të ndërmara nga organet kompetente në zbatim të procedurës të nisur për të cilën është bërë një njoftim publik, si vijim i një procedure koncensionare të identifikuar dhe nisur përpara miratimit të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Referuar sa më sipër denoncimet, nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të provojnë se janë veprimtari të ndaluara në kuptim të përkufizime të veprimtarive të ndaluara të përcaktuara në nenin 3 të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për kallëzimet e kryera nga Partia Demokratike pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, miratimi i VKM-së nr. 100, datë 17.2.2021, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në vendimin nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, 91 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:



## V E N D O S :

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimeve për arsye se nuk konstatohen elemente të shkeljes së dispozitave të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

